




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. Me këtë vendim thjeshtohen shërbimet komunale sipas shtojcës së bashkëngjitur këtij vendimi, me qëllim të zvogëlimit të barrës administrative për palët.
- II. **Obligohen drejtoritë komunale** për zbatimin e këtij vendimi, sipas shtojcës së bashkëngjitur, nga data 01.01.2025, si dhe **obligohet NjMBNj** të koordinojë me organet kompetente organizimin e trajnimeve për zyrtarët komunalë, me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- Drejtorive
- NjMBNj



Kryetari i Komunës
Fadil Nura

Shtojca: Zvogëlimi i Barrës Administrative (Thjeshtëzimi i Shërbimeve)

Nr.	SHËRBIMI	DREJTORIA/SEKTORI	DOKUMENTI QË NUK KËRKOHET MË NË PROCEDURE NGA PALA
1	Zyra për Biznese	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm	1. Mundësia e Aplikimi Online dhe lehtësira për aplikim për biznese.
2	Korrigjimi i emrit personal	Drejtoria për Administratë Sektori i Gjendjes Civile	1. Ekstrakti. 2. Certifikata e lindjes. 3. Certifikata e martesës. 4. Vërtetimi nga arkiva.
3	Korrigjimi dhe plotësimi në dokumentet e arkivuar	Drejtoria për Administratë Sektori i Gjendjes Civile	1. Kopja e regjistrit themeltar të lindjes. 2. Kopja e regjistrit themeltar të martesës. 3. Kopja e regjistrit themeltar të vdekjes.
4	Ndërrimi i emrit personal	Drejtoria për Administratë Sektori i Gjendjes Civile	1. Ekstrakti. 2. Certifikata e lindjes. 3. Vërtetimi i tatimit në pronë. 4. Vërtetimi nga arkiva.
5	Ndërrimi i emrit personal në rastet e rikthimit të mbiemrit të vajzërisë apo djalërisë pas shkurorëzimit	Drejtoria për Administratë Sektori i Gjendjes Civile	1. Ekstrakti. 2. Certifikata e lindjes. 3. Vërtetimi nga arkiva. 4. Vërtetimi i tatimit në pronë.
6	Bartja e pronës	DGJKP – Sektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë	1. Vërtetimi i Tatimit në Pronë (Nuk kërkohet më).
7	Këmbimi i Pronës	DGJKP – Sektori i Pronës	1. Vërtetim nga Urbanizmi për planin urbanistik të parcelës (Sigurohet zyrtarisht nga DGJKP përmes Drejtorisë së Urbanizmit).
8	Bartja e pronës	DGJKP – Sektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë	1. Dokumentacionet e ndryshme nga sektori i gjendjes civile kur na nevojitet vërtetimi i ndonjë të dhënë për palet që parashetrojnë kërkesë në ZKK (sigurohet zyrtarisht nga DGJKP përmes sektorit të gjendjes civile).